

## KOMITETI DREJTUES

Nr. 85 Prot.

Tiranë, 30 shtator 2024

### Vendim Nr. 4 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 26 shtator 2024, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve, znj. Migena Plasa, z. Juel Jarani, si dhe z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Tarifat për Kategorinë e I-rë Meshkuj 2024-25;
2. Shoqatat multisportive që kërkojnë anëtarësim;
3. Raport aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare 2023-24;
4. Shoqatat që kanë paraqitur kërkesë për anëtarësim;
5. Aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare deri në përfundim të vitit 2024;
6. Kompensim i rrugës së gjyqtarëve në ndeshjet jashtë Tiranës dhe Durrësit;
7. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës duke trajtuar problematikat për secilën pikë të sajë.

### **Për sa më sipër, KD-ja vendosi:**

1. Shtimin e një shënimi në përfundim të nenit 19, si vijon:  
“Në rastin e organizimit të Superligës Meshkuj dhe Kategorisë së I-rë Meshkuj, tarifat e pjesëmarrjes dhe transferimeve të përcaktuara për Kampionatin Kombëtar Meshkuj do të jenë të njëta për Superligën, ndërsa për Kategorinë e I-rë Meshkuj do të jenë 20 % më pak. Gjithashtu, do të ketë shpërblim për ekipin fitues të Kategorisë së I-rë Meshkuj në vlerën 100'000 lekë.”
2. Në bazë të ligjit nr. 79/2017 "Për sportin", të ndryshuar, Statutit të FSHB-së, si dhe synimeve afatgjata për zhvillimin e basketbollit në Shqipëri duke siguruar përkushtim të anëtarëve të saj në sportin e basketbollit, Federata Shqiptare e Basketbollit nuk mund të përfshijë në anëtarësimin e saj shoqata që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre zhvillimin e disa sporteve dhe synojnë anëtarësimin në disa Federata sportive.

3. Miratimin e Buletinit Informativ mbi zhvillimin e aktiviteteve sportive gjatë edicionit sportiv shtator 2023 – gusht 2024, si dhe udhëzimin e administratës për të përfunduar raportimet edicionale pranë MAS-së.
4. Miratimin në parim të kërkesës për anëtarësim të shoqatave:

Nr.	Shoqata	Vendimi Gjykatës	NIPT	Qyteti	Përfaqësues
1	Liburnët Basket	Nr. 5462, 21.10.2016	M21913701T	Durrës	Ina Sema
2	Tirana 10	Nr. 6516, 24.07.2020	M02004451S	Tiranë	Edmond Vaqarri

*\*Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori Teknik për verifikimin në terren të aktivitetit sportiv për shoqatat e sipërpërmendura.*

5. Miratimin e organizimit të Ligës Amatore, si dhe fillimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të parashikuara për edicionin deri në përfundim të vitit kalendarik 2024, duke siguruar organizimin në kushte optimale. Shortet për kampionatet kombëtare për të gjitha kategoritë e moshave U20, U18, U16, dhe U14, për djem dhe vajza, do të organizohen më datë 22 tetor në Tiranë, duke siguruar pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve dhe një organizim sa më dinjitoz. Superkupa Meshkuj do të realizohet më 7 tetor, ora 19:00, në pallatin e sportit Asllan Rusi sipas kërkesës së paraqitur për organizim nga ekipi Besëlidhja. Superkupa Femra do të organizohet në pallatin e sportit Apolonia, Fier, datë 8 tetor, ora 18:00.
6. Kompensim të shpenzimit të udhëtimit për gjyqtarët dhe vëzhguesit e ndeshjeve në kampionatet kombëtare të rritur/a të angazhuar në ndeshjet ku nevojitet të udhëtojnë mbi 100 km, duke shtuar 2'000 lek bruto në tarifën e gjykimit të përcaktuar në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare. Përfshihen nga ky vendim ndeshjet të cilat zhvillohen në Tiranë, Kamëz, Krujë, Laç, Lezhë, Klos, Bulqizë, Burrel, Vorë, Shijak, Durrës, Kavajë, Rogozhinë, Divjakë, Lushnje, Fier, Elbasan, Belsh, Cerrik, Peqin, Librazhd dhe Prrenjas.
7. Udhëzohet administrata të nisë njoftimet për shprehjen e interesit nga trajnerët që synojnë të angazhohen me ekipet kombëtare të moshave për vitin 2025, duke përcaktuar kriteret dhe kualifikimet përkatëse. Trajnerët mund të shprehin interesin e tyre për angazhim, pas së cilës FSHB do të vendosë për përfshirjen ose jo të tyre, si dhe për pozicionin dhe ekipin kombëtar ku mund të angazhohen.

